



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 30.03.2021

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR POZICIONET
E SHPALLURA NGA AZHBR**

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), në Vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, në shpalljen “Njoftim Punësimi” nr. 1098 prot, datë 23.03.2021, AZHBR njofton se pas përfundimit të verifikimit të kandidatëve, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

➤ **SPECIALIST NË SEKTORIN E AUDITIT TË BRENDSHËM**

(Kontratë pune 6h/ditë, kategoria IV-b)

• **Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit janë:**

1. Polokseni Koto
2. Suela Koto
3. Orkida Jica

Kandidatët e kualifikuar do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
- Njohuri mbi ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Njohuri mbi ligjin për auditin e brendshëm në sektorin publik.
- Njohuri mbi manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhër të ministrit të financave.
- Njohuri mbi ligjin për Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Aistencën e Paraantarësimit (IPA II).
- Njohuri mbi ligjin për Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për

rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Aistencën e Paraantarësimit (IPA II).

- A.** Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **31.03.2021, ora 10.30**, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë.
- B.** Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë **31.03.2021, ora 11:30** dhe në vazhdim, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë. Kandidatët do të paraqiten në intervistë sipas rendit alfabetik.

TË GJITHË KANDIDATËT PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT.

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL